REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Nr/Br. 444/23
Datë/Datum. 11.07.2023
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 444/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërjen nga Vedat Poterqoi-Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar, Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) OE " Rexha " me seli në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I LOT 2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Shtype i Madh- Qafa e Broqit LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin " Rekë e Allagës- Pecaj" LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Koshutan – Gunishtë LOT 5 Asfaltimi i rrugës " Koshutan Pepajë " LOT 6 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Kuqisht (Lagjja e Bardhaj) LOT 7 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë vazhdim pjesa II, me numër të prokurimit 635-22-11435-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues - Komuna e Pejës me 11.07.2023, mori:

VENDIM

1. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e operatorit ekonomik " Rexha " me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.06.2023 me numër protokolli 444/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I me numër të prokurimit 635-22-11435-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejës, pasi që operatoret ekonomik ankues konsiderohen si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-së.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues hedhet si e pa lejuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet

konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 12.06.2023, AK - Komuna e Pejës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së - Rivlerësim për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I LOT 2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Shtype i Madh- Qafa e Broqit LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin " Rekë e Allagës- Pecaj" LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Koshutan – Gunishtë LOT 5 Asfaltimi i rrugës " Koshutan Pepajë " LOT 6 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Kuqisht (Lagjja e Bardhaj) LOT 7 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë vazhdim pjesa II, me numër të prokurimit 635-22-11435-5-1-1.

Kundër Vendimit të cituar si më sipër OE ankues me datë 19.06.2023, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim. AK - Komuna e Pejës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datën 20.06.2023 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Me 30.06.2023, OE "Rexha" me seli në Prishtinë ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (Protokolli 444/23), kundër B58 Njoftimit mbi vendimin e AK-së-Rivlerësim të datës 12.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me numër dhe datë të përshkruar si më sipër.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me piken 16 të paragrafit 2 të nenit 105, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë Paneli konstatoi në vijim se:
Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesave, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të caktohet ekspertë shqyrtues e as të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit te te gjithë dokumentacionit te anekses dhe procedures se prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si pale pa interes juridik material, ku nder te tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas

të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 te këtij ligji". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar ne ketë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP dhe per këtë çështje juridike është dhënë një vendim me nr. 77/2023, me të cilin vendim ka kthyer aktivitetin e prokurimit në fjalë në rivlerësim pasi që ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së, sepse në shkresat e kësaj lende vërehet se AK nuk ka zbatuar drejtë dispozitat për prokurim publik në drejtim të operatorëve ekonomik. Lënda është kthyer në ri-vlerësim duke e bërë **OE të rekomanduar nga AK si të papërgjegjshëm** për këtë aktivitet të prokurimit, për arsye se noterizimi i kontratës së punës për menaxherin e projektit nuk është bërë konform kërkesave të Dosjes së tenderit dhe AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti nuk ka respektuar kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat që vete i ka specifikuar dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi gjegjësisht në kundërshtim me nenin 59.4 te LPP-se dhe në kundërshtim me nenin 40 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimi publik, në bazë të nenit 40.13 specifikohet saktë se "AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit", ndërsa për pajisjet e ofruara, sa i përket paisjes Riper Luge hidrauliku, Grupi i OE te rekomanduar për kontratë nuk kanë të prezantuar asnjë marrëveshje për qira apo dokument tjetër qe kjo pajisje është në pronësi të kompanisë dhe për këtë nuk mund të ofrohen informacione shtesë.

Andaj, mbi bazën e te lartcekurave, konsiderohet se OE ankues Rexha" me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstatimet e tij i bazon kryesisht në dispozite relevantet e LPP-së, te cilat parashohin dhe rregullojnë situatat e tilla, te cilat mund te paraqiten gjatë një aktiviteti te prokurimit sikurse ankesa nga grupi i OE ne këtë rast.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.77/23, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim. Ndërsa mbetet përgjegjësi e AK që vlerësimi i ofertave ta ketë bërë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe paragrafin 2 pika 16 të nenit 105 të Ligjit të cituar dhe ankesën e parashtruara nga OE "Rexha " me seli në Prishtinë hedhet si e pa lejuara.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;
1x1 AK – Komuna Pejë,
1x1OE "Rexha" me seli në Prishtinë
1x1 Arhivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së